



NORD-COMAT

Nord Construction Materials Laboratory

“SHERBIM I MIREMBAJTJES E PASTRIMI NGA BIMESIA I DIGES DHE UJELESHUESIT DHE KANALIT TE DRENAVE NE REZERVUARIN BUBQ”



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA KRUIJE
SEKTORI I BORDIT TE KULLIMIT**

RAPORTI TEKNIK

“SHERBIM I MIREMBAJTJES E PASTRIMI NGA BIMESIA I DIGES DHE UJELESHUESIT DHE KANALIT TE DRENAVE NE REZERVUARIN BUBQ”

Faza: PROJEKT ZBATIMI

“ Tirane 2019”

NORD COMAT

HEAD OFFICE - TIRANE; Mob:+355 692134888 NIPT: L 08501501 Q

Tirane, Dajt, Rruga "Muhamet Deliu" Pallat I Firmes "DODAJ", Kati I, afer Restorant Fresku; Tel 044525511; E-mail: nordcomat@yahoo.com



PERMBAJTJA E RAPORTIT

1. – TE PERGJITHSHME

- 1.1 – Hyrje
- 1.2 – Pozicionimi dhe te dhena te pergjithshme te objektit
- 1.3 – Qellimi i projektit

2. – GJENDJA EKZISTUESE

- 2.1- Trupi i Diges
- 2.1- Trupi i Diges
- 2.2 - Kurora e Diges
- 2.3 – Ekrani i Diges
- 2.4 – Kanali i Ujeleshuesit
- 2.5 – Kanalet e Drenave
- 2.6 – Saracineska e Shkarkimit
- 2.7 – Rruga e Aksesit per te Diga e Rezervuarit

3. – ZGJIDHJA E PROJEKTIT

- 3.1- Trupi i Diges
- 3.1- Trupi i Diges
- 3.2 - Kurora e Diges
- 3.3 – Ekrani i Diges
- 3.4 – Kanali i Ujeleshuesit
- 3.5 – Kanalet e Drenave
- 3.6 – Saracineska e Shkarkimit
- 3.7 – Rruga e Aksesit per te Diga e Rezervuarit

4. – KONKLUSIONE

5. – STUDIMI TOPOGRAFIK

6. – PREVENTIVI I PUNIMEVE



“SHERBIM I MIREMBAJTJES E PASTRIMI NGA BIMESIA I DIGES DHE UJELESHUESIT DHE KANALIT TE DRENAVE NE REZERVUARIN BUBQ”

1. - TE PERGJITHSHME

Bashkia e Krujes, per objektin: “Sherbim i Mirembajtjes e Pastrimi nga Bimesia i Diges dhe Ujeleshuesit dhe Kanalit te Drenave ne Rezervuarin Bubq”, ka parashikuar nje paraprake prej 4.200.000 Leke (me TVSH).

1.1 – HYRJE

Rrethi i Krujes, shtrihet ne Shqiperine e mesme, pjeserisht ne krahinen malore qendrore dhe pjeserisht ne ultesiren perendimore.

Fshati Bubq pjese e Njesise Administrative Bubq ndodhet rreth 15 km ne veri te qytetit te Tiranës. Njesia Administrative Bubq qe perbehet nga 7 fshatra me rreth 5950 banore, shtrihet ne nje terren rreth 70 % fushor dhe 30 % kodrinor.

Sipas ndarjes klimatike te dhene ne Klimen e Shqiperise (Botim Hidmet Tirana, 1975), klima e Bubqit perfshihet ne zonen klimatike Mesdhetare te Fushes Qendrore. Reshjet mesatare vjetore jane rreth 1200-1300mm ne vit. Te shperndara si vijon: ne dimer rreth 420mm, ne pranvere rreth 340mm, ne vere rreth 150mm dhe ne vjeshte rreth 360mm. Temperaturat mesatare per te gjithe zonen jane rreth 15.2°C. Ne Dimer rreth 5.5°C, ne pranvere rreth 13.6°C, ne vere rreth 23.1°C dhe ne Vjeshte rreth 16°C. Ererat zoteruese veriperendim dhe juglindje. Ne vere ndihet ndikimi freskues i puhise detare.

Bimesia dallohet per periudhen e gjate te vegetacionit mbi 10 muaj. Bimesia e kesaj zone perbehet kryesisht nga shkurre dhe barishte, tipike keto bime per zona fushore me lartesi te ulet nga niveli i detit. Vlen per t’u theksuar prodhimtaria e larte e tokave ne kete zone.

Bujqesia ne Bubq eshte e zhvilluar mire, duke kultivuar dritherat dhe bimet foragjere. Vitet e fundit, disa fermere kane rifilluar kultivimin e vreshtarise dhe te serave me perime. Bujqesia mbeshtetet kryesisht edhe ne blegtorine.

Kjo zone dallohet edhe per zhvillimin e blegtorise, ku ka nje mbareshtim me te madh te gjedhit, meqe ne keto zona kultivohen me shume foragjeret dhe kultura e misrit per blegtorine. Ndersa per disa zona shume afer Bubqit, mbareshtohen me teper te imtat, dele dhe dhi.

Rendimenti prodhues per njesi siperfaqe ne komunën Bubq eshte i larte, kjo per faktin se tokat jane shume prodhuese dhe sistemi i drenazimit te tyre funksionon shume mire.



“SHERBIM I MIREMBAJTJES E PASTRIMI NGA BIMESIA I DIGES DHE UJELESHUESIT DHE KANALIT TE DRENAVE NE REZERVUARIN BUBQ”

Rezervuari i Bubqit si rezultat i mungeses se mirembajtjes gjate viteve te fundit eshte ne gjendje mjaft te keqe, nder problematikat kryesore jane;

- I gjithe trupi i diges eshte i mbuluar nga bimesia, te cilat shkojne nga shkurret deri ne peme me diameter $\div 70$ cm.
- Kurora e diges eshte e mbuluar nga bimesia dhe ka pesuar disa deformime te cilat ndihmojne krijimin e pellgjeve ujembajtese gjate stineve me te reshura.
- Ekranit i diges ne te dy ekstremet e saj eshte i demtuar dhe verehet procesi i erozionit nga dallget e ujit, dhe pergjate gjithe ekranit verehen levizje te gureve si rezultat i rritjes se bimesise.
- Kanali i ujeleshuesit eshte i mbushur nga dherat nderkohe qe tubi metalik i derdhjes se ujeleshuesit ne kanalit e drenave mungon.
- Kanali i drenave ne fundin e diges eshte i mbuluar totalisht nga bimesia dhe pemet, nderkohe qe kanali drenazhues prej betoni ne bermen e diges eshte totalisht i bllokuar.
- Saracineska e shkarkimit ka rrjedhje edhe pse eshte ne pozicionin e mbyllur, nderkohe qe kanali i shkarkimit qe shkon ne drejtim te kanalit te drenes ne fund te diges eshte i bllokuar totalisht.
- Rruga e aksesit per ne digen e rezervuarit eshte ne gjendje mjaft te keqe (aktualisht mund te kalohet me mjete te larta ndersa ne mot me te reshura kalimi eshte i pamundur).

Ne kete kuader Bashkia e Krujes, ka planifikuar pergatitjen e nje projekti per “Sherbim i Mirembajtjes e Pastrimi nga Bimesia i Diges dhe Ujeleshuesit dhe Kanalit te Drenave ne Rezervuarin Bubq”, nepermjet te cilit do te permiresohet sado pak gjendja e kushteve te diges se rezervuarit Bubq. Per zgjidhjen perfundimtare te problematikave te sipershenuara por edhe per vendosjen ne funksion (vaditjen e tokave bujqesore) te ketij rezervuari nevojiten fonde te konsiderueshme te cilat duhet te parashikohen sa me shpejt nga Bashkia Kruje ose Ministria e Bujqesise.

1.2 –POZICIONIMI DHE TE DHENA TE PERGJITHSHME PER OBJEKTIN

Objekti “Sherbim i Mirembajtjes e Pastrimi nga Bimesia i Diges dhe Ujeleshuesit dhe Kanalit te Drenave ne Rezervuarin Bubq”, Njesia Administrative Bubq, objekt per te cilin do te hartohet studim projektimi, shtrihet ne fshatin Bubq te njesise administrative Bubq te Bashkise Kruje.

Rezervuari Bubq pozicionohet ne pjesen perendimore te fshatit Bubq, ne nje dstance rreth 3 km nga qendra e Fshatit. Rruga qe te con ne Rezervuarin Bubq eshte e mire deri ne fund te zones se banuar dhe eshte e aksesueshme ne cdo stine te vitit ndersa pjesa fundore e saj (gjatesi rreth 450 ml) eshte ne gjendje te keqe dhe e aksesueshme vetem ne stinet e thata.



“SHERBIM I MIREMBAJTJES E PASTRIMI NGA BIMESIA I DIGES DHE UJELESHUESIT DHE KANALIT TE DRENAVE NE REZERVUARIN BUBQ”

Diga e ujembledhësit të bubqit është një digë gravitacionale me gjatësi 150 m (në kurorë) dhe lartësi 18 m. Ekranit të digës së rezervuarit (faqja e brendshme) është e veshur me gure kave, ndërsa faqja e jashtme është me material vendi (dhe) e ndarë nga një bermë me gjatësi 2,5 m dhe një kanal betoni në anë të saj. Në fundin e digës është i pozicionuar kanali prej dheu i drenave në të cilin derdhet kanali i ujeleshuesit, kanali i sipërm i drenazhimit dhe kanali i shkarkimit.

1.3 – QELLIMI I PROJEKTIT

Nepërmjet “Sherbim i Mirëmbajtjes e Pastrimi nga Bimesia i Digës dhe Ujeleshuesit dhe Kanalit të Drenave në Rezervuarin Bubq” do të nderhyhet në:

- Pastrimi i bimesisë në trupin e digës (ekranit të digës, kurorë e digës dhe skarpata e jashtme e digës përfshi edhe kanalet e drenave), dhe rrafshimi i skarpateve të jashtme dhe bermës të digës.
- Riparimi i kurorës së digës me material cakullor dhe dhënia e pjerresisë e largimin e ujërave sipërfaqësore.
- Riparimi i ekranit të digës në të dy ekstremet e saj dhe sistemi i gureve përgjatë ekranit ekzistues.
- Pastrimi i kanalit të ujeleshuesit. Riparimi i tubit metalik të derdhjes së ujeleshuesit në kanalit të drenave.
- Pastrimi i kanalit të drenave në fundin e digës. Nderim i kanalit drenazhues prej betoni në bermen e digës.
- Riparim i saracineskës së shkarkimit për eliminimin e rrjedhjeve. Riparimi i kanalit të shkarkimit që shkon në drejtim të kanalit të drenës në fund të digës.
- Riparim i rrugës së aksesit për në digën e rezervuarit.

“SHERBIM I MIREMBAJTJES E PASTRIMI NGA BIMESIA I DIGES DHE UJELESHUESIT DHE KANALIT TE DRENAVE NE REZERVUARIN BUBQ”

2. – GJENDJA EKZISTUESE

Sipas informacioneve te siguruara, inspektimin ne vend nga ana e grupit projektues, verifikimeve, gjendja ekzistuese ne kete objekt, ne teresine e tij, paraqitet si meposhte:

2.1- TRUPI I DIGES

- I gjithe trupi i diges eshte i mbuluar nga bimesia, te cilat shkojne nga shkurret deri ne peme me diameter ÷ 70 cm.






“SHERBIM I MIREMBAJTJES E PASTRIMI NGA BIMESIA I DIGES DHE UJELESHUESIT DHE KANALIT TE DRENAVE NE REZERVUARIN BUBQ”



2.2 - KURORA E DIGES

- Kurora e diges eshte e mbuluar nga bimesia dhe ka pesuar disa deformime te cilat ndihmojne krijimin e pellgjeve ujembajtese gjate stineve me te reshura.




“SHERBIM I MIREMBAJTJES E PASTRIMI NGA BIMESIA I DIGES DHE UJELESHUESIT DHE KANALIT TE DRENAVE NE REZERVUARIN BUBQ”



2.3 – EKRANI I DIGES

- Ekrani i diges ne te dy ekstremet e saj eshte i demtuar dhe verehet procesi i erozionit nga dallget e ujit, dhe pergjate gjithë ekranit verehen levizje te gureve si rezultat i rritjes se bimesise.



“SHERBIM I MIREMBAJTJES E PASTRIMI NGA BIMESIA I DIGES DHE UJELESHUESIT DHE KANALIT TE DRENAVE NE REZERVUARIN BUBQ”



2.4 – KANALI I UJELESHUESIT

- Kanali i ujeleshuesit eshte i mbushur nga dherat nderkohe qe tubi metalik i derdhjes se ujeleshuesit ne kanalिन e drenave mungon.



“SHERBIM I MIREMBAJTJES E PASTRIMI NGA BIMESIA I DIGES DHE UJELESHUESIT DHE KANALIT TE DRENAVE NE REZERVUARIN BUBQ”



2.5 – KANALET E DRENAVE

- Kanali i drenave ne fundin e diges eshte i mbuluar totalisht nga bimesia dhe pemet, nderkohe qe kanali drenazhues prej betoni ne bermen e diges eshte totalisht i bllokuar.



“SHERBIM I MIREMBAJTJES E PASTRIMI NGA BIMESIA I DIGES DHE UJELESHUESIT DHE KANALIT TE DRENAVE NE REZERVUARIN BUBQ”



2.6 – SARACINESKA E SHKARKIMIT

- Saracineska e shkarkimit ka rrjedhje edhe pse eshte ne pozicionin e mbyllur, nderkohe qe kanali i shkarkimit qe shkon ne drejtim te kanalit te drenes ne fund te diges eshte i bllokuar totalish.



NORD-COMAT

Nord Construction Materials Laboratory

“SHERBIM I MIREMBAJTJES E PASTRIMI NGA BIMESIA I DIGES DHE UJELESHUESIT DHE KANALIT TE DRENAVE NE REZERVUARIN BUBQ”



NORD COMAT

HEAD OFFICE - TIRANE; Mob:+355 692134888 NIPT: L 08501501 Q

Tirane, Dajt, Rruga "Muhamet Deliu" Pallat I Firmes "DODAJ", Kati I, afer Restorant Fresku; Tel 044525511; E-mail: nordcomat@yahoo.com




“SHERBIM I MIREMBAJTJES E PASTRIMI NGA BIMESIA I DIGES DHE UJELESHUESIT DHE KANALIT TE DRENAVE NE REZERVUARIN BUBQ”



2.7 – RRUGA E AKSESIT PER TE DIGA E REZERVUARIT

- Rruga e aksesit per te diga e rezervuarit eshte ne gjenjde mjaft te keqe (aktualisht mund te kalohet me mjete te larta ndersa ne mot me te reshura kalimi eshte i pamundur).





NORD-COMAT

Nord Construction Materials Laboratory

“SHERBIM I MIREMBAJTJES E PASTRIMI NGA BIMESIA I DIGES DHE UJELESHUESIT DHE KANALIT TE DRENAVE NE REZERVUARIN BUBQ”



Albania

NORD COMAT

HEAD OFFICE - TIRANE; Mob:+355 692134888 NIPT: L 08501501 Q

Tirane, Dajt, Rruga "Muhamet Deliu" Pallat I Firmes "DODAJ", Kati I, afer Restorant Fresku; Tel 044525511; E-mail: nordcomat@yahoo.com



3 – ZGJIDHJA E PROJEKTIT

Studim-Projektimi per objektin “Sherbim i Mirembajtjes e Pastrimi nga Bimesia i Diges dhe Ujeleshuesit dhe Kanalit te Drenave ne Rezervuarin Bubq”, eshte realizuar ne baze te Detyres se Projektimit si dhe kerkesave te perfaqesuesve te Bashkise Kruje, gjate vizites ne kantier, nepermjet te cilave do te nderhyhet ne:

3.1- TRUPI I DIGES

Do te kryhet pastrimi i bimesise ne trupin e diges si me poshte;

- Ekranit i diges(faqja e brendshme), do te pastrohet nga bimesia nepermjet prerjes se bimesise se ulet me krahe. Pemet qe ndodhen ne pjesen e ekranit dhe kurores se diges mbas prerjes dhe largimit te lendes drusore do te behet shkulja e rrenjeve dhe rehabilitimi i zones nepermjet mbushjes e ngjeshjes se dheut natyror.
- Skarpata e jashtme e diges dhe berma do te pastrohet nga bimesia nepermjet prerjes se bimesise se ulet me krahe. Pemet qe ndodhen ne pjesen e skarpates se jashtme dhe bermes se diges mbas prerjes dhe largimit te lendes drusore do te behet shkulja e rrenjeve dhe rehabilitimi i zones nepermjet mbushjes e ngjeshjes se dheut natyror. E gjithë sipërfaqja e pastruar do te rrafshohet me eskavator me zinxhire lopat kundert nepermjet koves pa dhembe.

3.2 - KURORA E DIGES

Do te kryhet riparimi i kurores se diges me nje shtrese material cakullor, dhe dhania e pjerresise e largimin e ujerave sipërfaqesore. Kuota e diges do te mbetet e pandryshuar (pra do te ruhet kouta ekzistuese), do te behet sistemim i gropezimeve e deformimeve te krijuara si rezultat i mungeses se mirembajtjes. Cakelli do te vendoset mbas skarifikimit te sipërfaqes ekzistuese e cila do te cilindrohet. Kuotat e aplikimit te shtreses nveluese te cakellit te meren ne profilat terthor te projektit te zbatimit.

3.3 – EKRANI I DIGES

Do te kryhet riparimi/ndertimi i ekranit te diges ne te dy ekstremet e saj nepermjet vendosjes se gureve gelqeror me dimensione dhe forme sipas gureve qe jane perdorur per ndertimin e ekranit ekzistues. Zonat qe jane per tu riparuar/ndertuar do te meren ne projektin e zbatimit dhe do te pershtaten sipas udhezimeve te Mbikqyresit te Punimeve. E gjithë sipërfaqja e ekranit te diges do te kontrollohet e riparohen guret e kaves qe kane levizur gjate viteve si rezulat i bimesise, dallgeve te liqenit apo agjenteve te ndryshem atmosferik.



“SHERBIM I MIREMBAJTJES E PASTRIMI NGA BIMESIA I DIGES DHE UJELESHUESIT DHE KANALIT TE DRENAVE NE REZERVUARIN BUBQ”

3.4 – KANALI I UJELESHUESIT

Do te kryhet pastrimi i kanalit te ujeleshuesit nga dherat qe kane mbushur kanalim si rezultat i erozionit dhe mungeses se mirembajtjes. Kanali do te pastrohet ne te gjithe gjatesine e tij perfshi edhe puseten dhe kanalim e dergimit te kanali i drenave ne fund te diges. Pastrimi do te behet me eskavator dhe me krahe.

Do te kryhet riparimi i tubit metalik $D=508\text{mm}$ te derdhjes se ujeleshuesit ne kanalim e drenave. Tubi do te kapet nepermjet saldimit te tubi qe del nga puseta e kanalit te ujeleshuesit dhe do te kete 2 (dy) brryla me 90 grade dhe nje 45 grade per tu derdhur ne pjesen tjeter prej betoni te kanalit te ujeleshuesit. Tubi duhet te futet poshte trasese se bermes me te cilen nderpritet, me qellim zvogelimin e mundesise se vjedhjes. Dherat qe do te dalin nga germimi do te largohen ne vendepozitimim me te afert qe do te miratohet nga Bashkia Kruje.

3.5 – KANALET E DRENAVE

Nga azhornimet ne terren verehet se per largimin e ujerave siperfaqesore jane perdorur dy kanale:

- Kanal prej betoni i pozicionuar ndermjet skarpates se siperme dhe bermes se diges, kanal i cili eshte parashikuar qe te ribehet i ri. Kanali do te kete forme trapezoidale dhe do te jete prej betoni te klases C16/20, me spesor $t=10\text{ cm}$. Kanali do te derdhet ne kanalim e dheut ne fund te diges. Gjeometria dhe Kuotat e kanalit te betonit te meren ne planimetri dhe profilat terthor te projektit te zbatimit.
- Kanali prej dheu ne fund te diges i cili do te pastrohet ne te gjithe gjatesine e tij. Pastrimi i kanalit te drenave ne fundin e diges do te behet me eskavator. Dherat qe do te dalin nga germimi do te largohen ne vendepozitimim me te afert qe do te miratohet nga Bashkia Kruje. Gjeometria dhe Kuotat e kanalit te betonit te meren ne planimetri dhe profilat terthor te projektit te zbatimit.

3.6 – SARACINESKA E SHKARKIMIT

Do te kryhet riparim i saracineskes ekzistuese se shkarkimit $D=500\text{mm}$, per eleminimin e rrjedhjeve. Nga sa u konstatua gjate azhornimit ne terren edhe nga konsulta me perfaqesues te Investitorit, u vendosh qe saracineska ekzistuese te riparohet, duke hapur kapakun e siperme te saracineskes nepermjet prerjes se bulonerise ekzistuese (kujdes te perdoret prerje me oksigjen) dhe te behet zevendesimi i guarnicioneve ekzistuese.

I gjithe procesi i riparimit te saracineskes ekzistuese $D=500\text{mm}$, do te kryhet nen prezencen dhe mbikqyrjen e perfaqesuesve te Investitorit (Staf Inxhinierik) dhe Mbikqyresit te Punimeve, per te shmangur cdo aksident te mundeshem.

Do te kryhet pastrimi i kanalit te shkarkimit nga puseta e saracineskes ekzistuese $D=500\text{mm}$ deri te kanali i drenes ne fund te diges. Referohu planimetrise se projektit te zbatimit.



“SHERBIM I MIREMBAJTJES E PASTRIMI NGA BIMESIA I DIGES DHE UJELESHUESIT DHE KANALIT TE DRENAVE NE REZERVUARIN BUBQ”

3.7 – RRUGA E AKSESIT PER TE DIGA E REZERVUARIT

Do te kryhet riparim i rruges se aksesit per ne digen e rezervuarit. Per rrugen eshte parashikuar ndertimi i nje kanali kullues anesor per ruajtjen e trupit te rruges nga ujerat siperfaqesore, dhe ndertimi i nje shtrese me cakell naturor gurore.

Per te respektuar vleren e parashikuar nga Investitori per kete objekt, per rrugen e aksesit eshte parashikuar gërmim per kanale anesore dhe sistemim nivelete rreth 320 m³ dhe cakell gurore rreth 240 m³. Shperndarja e ketyre volumeve do te behet ne bashkepunim me perfaqesues te Investitorit dhe Mbikqyresin e Punimeve.

4. –KONKLUZIONE

Nepermjet kontrates “Sherbim i Mirembajtjes e Pastrimi nga Bimesia i Diges dhe Ujeleshuesit dhe Kanalit te Drenave ne Rezervuarin Bubq”, parashikohet te nderhyhet dhe do te permiresohen;

- Pastrimi i bimesise ne trupin e diges (ekrani i diges, kurora e diges dhe skarpata e jashtme e diges perfshi edhe kanalet e drenave), dhe rrafshimi i skarpateve te jashtme dhe bermes te diges.
- Riparimi i kurores se diges me material cakullor dhe dhënia e pjerresise e largimin e ujerave siperfaqesore.
- Riparimi i ekranit te diges ne te dy ekstremet e saj dhe sistemi i gureve pergjate ekranit ekzistues.
- Pastrimi i kanalit te ujeleshuesit. Riparimi i tubit metalik te derdhjes se ujeleshuesit ne kanalin e drenave.
- Pastrimi i kanalit te drenave ne fundin e diges. Ndertim i kanalit drenazhues prej betoni ne bermen e diges.
- Riparim i saracineskes se shkarkimit per eleminimin e rrjedhjeve. Riparimi i kanalit te shkarkimit qe shkon ne drejtim te kanalit te drenes ne fund te diges.
- Riparim i rruges se aksesit per ne digen e rezervuarit.

Per zgjidhjen perfundimtare te problematikave te diges se rezervuarit Bubq edhe per vendosjen ne funksion (vaditjen e tokave bujqesore) te ketij rezervuari nevojiten fonde te konsiderueshme te cilat duhet te parashikohen sa me shpejt nga Bashkia Kruje ose Ministria e Bujqesise.

Per “NORD COMAT” Sh.p.k.
Ing. Besnik Muceku
Ing. Ermir Çupi
Ing. Klodian GOXHARAJ
Ing. Ossama L.EGLADIOUS

NORD COMAT

HEAD OFFICE - TIRANE; Mob:+355 692134888 NIPT: L 08501501 Q

Tirane, Dajt, Rruga "Muhamet Deliu" Pallat I Firmes "DODAJ", Kati I, afer Restorant Fresku; Tel 044525511; E-mail: nordcomat@yahoo.com



5. – STUDIMI TOPOGRAFIK

Zona ne te cilin shtrihet objekti Studim-Projektim “**Sherbim i Mirembajtjes e Pastrimi nga Bimesia i Diges dhe Ujeleshuesit dhe Kanalit te Drenave ne Rezervuarin Bubq**”, ndodhet ne fshatin Bubq te Njesise Administrative Bubq, Bashkia Kruje.

Per hartimin e projektit dhe per nxjerrjen e nje serie te dhenash jane shfrytezuar hartat topografike te zones ne shkallet 1: 25.000 dhe 1:10.000, fotot ajrore dhe satelitore te zones si dhe matjet e drejtperdrejta ne terren.

Punimet Gjeodezike

Punimet gjeodezike dhe topografike per objektin “**Sherbim i Mirembajtjes e Pastrimi nga Bimesia i Diges dhe Ujeleshuesit dhe Kanalit te Drenave ne Rezervuarin Bubq**”, kryen mbi bazen e kerkesave teknike te pergjitheshme dhe specifike te parashikuara nga Investitori. Grupi i Topografeve organizoi punen dhe zhvilloi punimet ne baze te pervojes se perfituar ne punimet e meparshme te kesaj natyre. Para fillimit te punimeve topografike u siguruan materialet e nevojshme hartografike, gjeodezike si dhe paisjet perkatese.

Per te siguruar lidhjen gjeodezike unike te te gjitha projekteve nga shoqeria u shfrytezuan te dhenat gjeodezike te rrjetit shteteror te triangulacionit dhe nivelimit. Sistemi qe perdor Republika e Shqiperise eshte projeksioni Gauuss Kryger-it me ellipsoid Krasovsky-n.

Rilevimi eshte bere ne sistemin nderkombetar me projeksionin UTM me ellipsoid WGS84. Duke patur parasysh zonen dhe ritmin e zhvillimit qe ajo ka, do te ishte me frytedhense nese do te perdorej dhe ky sistem. Me kete sistem mund te percaktohet lehtesisht kordinatat gjeodezike per cdo pike mbi siperfaqen tokesore nepermjet perdorimit te GPS.

Gjate rikonicionit ne terren u vendosen pikat e triangulacionit dhe markat e nivelimit ne pikat e fiksuara ne terren. Pikat e fiksuara ne terren u pajisen me koordinata ne projeksionin UTM ellipsoid WGS84 dhe kuota. Para fillimit te rilevimit u krye rikonicioni i detajuar i terrenit, i cili sherbeu per percaktimin e sakte te metodikes se punes, menyren e ndertimit te rrjetit gjeodezik, poligonometrise se rilevimit, nivelimit teknik si dhe organizimit te punes.

Fiksimi ne terren i pikave te rilevimit u krye me goxhde betoni te ngulura ne objekte betoni. Ato jane vendosur ne vende te dukshme dhe te pa levizeshme. Identiteti i tyre eshte fiksuar me boje te kuqe te shkruajtur ne afersi te pikes fikse ne vende te



“SHERBIM I MIREMBAJTJES E PASTRIMI NGA BIMESIA I DIGES DHE UJELESHUESIT DHE KANALIT TE DRENAVE NE REZERVUARIN BUBQ”

dukeshme nga rruga ekzistuese ose terreni. Ato jane vendosur ne vende te qendrueshme, ne ane te rruges ose afer saj, duke siguruar ne kete menyre lidhjen dhe vazhdimesine e punes nga faza e projektimit ne ate te zbatimit te tij.

Çdo pike e fiksuar ne terren ka numrin, koordinatat te saj, si dhe lartesine te perftuar nepermjet nivelimit gjeometrik e gjeodezik (shih planimetrite e objekteve ku gjenden koordinatat tre dimensionale te pikave mbeshtetese). Keto te dhena sigurojne gjetjen e tyre me lehtesi ne terren.

Pikat fikse te terrenit jane te percaktuara ne planimetrine e objektit qe perfshihen ne projekt.

Matjet u kryen me GPS TRIMBELL R6, Stacion Total te tipit Leica 307, Stacion Total te tipit Trimble M3 si dhe me nivele, te cilet teknikiisht siguron matjet e kendeve e largesive me saktesine e nevojshme per projektimin e rrugeve.



**Leica 307
TOPCON GPT 900 A**



TRIMBELLR6

Zhvillimi i Nivelimit Gjeometrik

Per te siguruar kerkesat e larta teknike ne punimet rlevuese, u percaktua qe saktesia altimetrike e punimeve topografike te jete e larte dhe per kete qellim u zhvillua nivelim gjeometrik per pikat e poligonometrise ne te gjithë sektoret e rruges dhe shesheve.

Nivelimi gjeometrik u krye me nivelen teknike te tipit Kern Level, me metoden e nivelimit teknik te dyfishte, duke matur çdo disnivel dy here, me dy vendosje instrumenti. Diferenca midis dy disniveleve te perftuar ne çdo stacion nuk u lejua me teper se 3 mm.



“SHERBIM I MIREMBAJTJES E PASTRIMI NGA BIMESIA I DIGES DHE UJELESHUESIT DHE KANALIT TE DRENAVE NE REZERVUARIN BUBQ”

Rilevimi

Duke u mbeshtetur ne pikat e poligonometrise dhe te nivelimit gjeometrik u zhvillua procesi i matjeve topografike

Eshte rilevuar ne menyre te plote e gjithë siperfaqja e zones ku shtrihet objekti si dhe e nje brezi perimetral qe e qarkon ate. Ne relief jane pasqyruar ne menyre te plote te tere elementet perberes te tij, kanale, puseta, platforma betoni, shtylla ndricimi ose tensioni, bunkere, tombino, trotuare, ndertesa, objekte te ndryshem, rruge kryesore e dytesore, perrenj, nje numer i dendur pikash detaje etj. Punimet topogjeodezike te kryera jane mbeshtetur ne shkallen e plote te pergatitjes profesionale, ne perdorimin e teknologjive bashkekohore per matjet fushore dhe perpunimin kompjuterik e te dhenave, per te plotesuar kerkesat teknike te parashtruara nga projektuesit. Çdo pike e mare ne teren ka koordinata tre dimensionale, te paraqitura ne projekt.

Perpunimi i materialit topografik ne zyre eshte bere me programin TOPKO nga ku eshte perftuar rilievi tre dimensional i objektit. Ky relief sherbeu per hartimin e projektit te zbatimit me saktesine dhe cilesine e kerkuar ne termat e references nga investitori.

Ne materialin grafik te projektit jepet planimetria e pikave poligonale dhe tabela e koordinatave te pikave te vendosura ne terren.

Pershkrimi i punes ne terren.

Per mbeshtetjen e punimeve fillimisht u krijua bazamenti gjeodezik ne formen e nje poligoni te hapur (pika te forta) te cilat jane te mjaftueshme per marrjen (matjen) e pikave detaje te rilevimit. Matja e ketyre pikave u kryen me metoden statike duke qendruar ne pike rreth 40 min ne intervalin 1 sek duke siguruar saktesi milimetrike te koordinatave te pikave.

Prania e marresit baze ne largesi te kufizuar siguron saktesi me te larte te matjeve ne interval kohe me te shkurter. Keshtu per pikat deri ne 1km nga marresi baze u perdor intervali 10 sek me matje per çdo sekonde. Element kryesor ne matjen ‘stop&go’ eshte mos humbja e lidhjes se fazes bartese gje e cila prish zgjidhjen perfundimtare. Kjo mund te realizohet duke shmager futjen ne zona hije te sinjalit ose zona me reflektim te madh sinjali. Ne kete rast marresit TRIMBLE R6 japin nje sinjal i cili lajmeron matesin se duhet te rifilloje matjen nga nje pike matur paraprakisht, duke siguruar saktesine e kerkuar.

Ne zonat me dendesi ndertimesh u perdor Stacioni Total pasi kishte peme dhe ndertime te larta te cilat nuk lejojne matjen e pikave detaje me GPS.


Bashkangjitur kemi paraqitur Katalogun e Skicave te Pikave Poligonale per te ndihmuar gjetjen e tyre lehtesisht gjate zbatimit te projektit.



“SHERBIM I MIREMBAJTJES E PASTRIMI NGA BIMESIA I DIGES DHE UJELESHUESIT DHE KANALIT TE DRENAVE NE REZERVUARIN BUBQ”


Pika Poligonale Nr.1 (BM.1)

Planimetria e pikes



Pika Poligonale Nr.2 (BM.2)

Planimetria e pikes



Per “NORD COMAT” Sh.p.k.
Ing. Besnik Muceku
Ing. Ermir Çupi
Ing. Klodian GOXHARAJ
Ing. Ossama L.EGLADIOUS

NORD COMAT

HEAD OFFICE - TIRANE; Mob:+355 692134888 NIPT: L 08501501 Q

Tirane, Dajt, Rruga "Muhamet Deliu" Pallat I Firmes "DODAJ", Kati I, afer Restorant Fresku; Tel 044525511; E-mail: nordcomat@yahoo.com